



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**Legjislatura VIII**  
**Sesioni vjeshtor**

---

Komisioni për Punë të Jashtme dhe Diasporë  
Mbledhja nr. 70  
Prishtinë, më 06.12.2023, në orën 10:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

**Procesverbal**

**Në mbledhje morën pjesë:** Arbëreshë Kryeziu-Hyseni, Xhavit Haliti, Gazmend Gjyshinca, Ariana Musliu-Shoshi, Doarsa Kica-Xhelili, Time Kadrijaj dhe Bahrim Shabani.

**Munguan:** Adelina Grainca, Yllza Hoti dhe Fitore Pacolli-Dalipi,

**Në këtë takim i pranishëm ishte:** z. Petrit Malaj, Ambasador i Republikës së Shqipërisë në Kosovë me bashkëpunëtoren znj. Pranvera Teli, ministre-këshilltare.

**Pjesëmarrës të tjerë:** Fatbardhë Kërçeli, Ron Ukaj, Kuvend D+; Drin Podrimçaku, GP-LVV; Liridona Gashi, Leudita Mejzini, Blendi Gashi, Besarta Pllana, Kuvendi; Alisa Thaqi, GP-AAK.

**Nga Zyra e Komisionit:** Manush Krasniqi.

**Takimin e kryesoi:** Arbëreshë Kryeziu- Hyseni, kryetare e Komisionit.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 21 dhe 24 nëntor 2023;
3. Takim i komisionit me z. Petrit Malaj, Ambasador i Republikës së Shqipërisë në Kosovë;
4. Të ndryshme.

**3. Takim i komisionit me z. Petrit Malaj, Ambasador i Republikës së Shqipërisë në Kosovë;**

**Arbëreshë Kryeziu-Hyseni**, i uroj mirëseardhje ambasadorit në mbledhjen e komisionit dhe theksoi se ky takim është i karakterit njoftues dhe për tu koordinuar për punët që i presin dy shtetet në vazhdim.

**Petrit Malaj**, tha se është i kënaqur që është para deputetëve të Kuvendit të Kosovës në rolin e përfaqësuesit të shtetit Shqiptar në Kosovë. Njoftoi për takimet që i ka pasur deri më tani, si me krerët

e shtetit, po ashtu, edhe me përfaqësuesit diplomatikë në Kosovë. Shqipëria, tha se ka qenë dhe do të jetë përherë krah i Kosovës dhe një mbështetëse e fuqishme e saj. Shqipëria e mbështetë fuqishëm KFOR-in dhe se vitin e ardhshëm do të shtojë forcat e saj ushtarake në kuadër të KFOR-it. Malaj, bëri të ditur se me 14 dhe 15 dhjetor BE-ja do të votojë për futjen e detyrimit të njohjes së marrëveshjes bazë të Brukselit dhe aneksin e zbatimit të saj, pikërisht për kapitullin 35 të negociimit me Serbinë. Do të votohet detyrimi për njohjen e Kosovës nga ana e Serbisë, që është një moment shumë i rëndësishëm. Lidhur me këtë shtoi se Shqipëria është mbështetëse e fortë e dialogut dhe se Qeveria Shqiptare përherë ka kërkuar që hapat të jenë më të shpejtë dhe se gjithçka të përfundojë me njohje reciproke dhe të normalizohen marrëdhëniet në mes të Kosovës dhe Serbisë. Shqipëria e përdor fuqishëm zërin e saj në përkrahje të Kosovës në të gjithë mekanizmat ndërkombëtarë.

Më 14 dhjetor, tha se do të mbahet takimi i ministerialit për energji, që është incizuar në vitin 2005. Në këtë nismë Kosova akoma figuron me UNMIK. Bëri të ditur se për këtë çështje ministritë e jashtme kanë komunikuar për të ditur se çfarë kërkohet nga Kosova, pasi që ky ministerial udhëhiqet nga Shqipëria këtë radhë. Me Kosovën, tha se ka shumë lidhje, se është rritur me historinë e saj dhe se është i edukuar familjarisht me historinë e saj. Shtoi se e do Kosovën dhe se do të bëjë gjithçka që Kosova të njoh hapat e saj të rëndësishëm në këto momente që po kalon, të cilat janë zgjatur, por është një proces i cili ka kërkuar mund dhe sakrifica për të ardhur tek këto momente të rëndësishme.

**Arbëreshë Kryeziu-Hyseni**, tha se padyshim që Kosova dhe Shqipëria në vazhdimësi kanë pasur raporte të mira sa i përket bashkëpunimit parlamentar e qeveritar. Komisioni para disa muajve ishte në Tiranë, ku u takuan me komisionin homolog, si dhe me komisione e delegacione në asamblëtë parlamentare që Kuvendi i Shqipërisë i ka, për tu koordinuar dhe për të parë se ku gjendemi në lobimin që ata po e bëjnë për Republikën e Kosovës. Para disa javësh, KPJD ka organizuar një tryezë të përbashkët me vendet e Ballkanit Perëndimor, ku prezentë ishin Komisioni për Politikën e Jashtme dhe ai për Çështjet Evropiane të Kuvendit të Shqipërisë, që do të thotë se tashmë bashkëpunimi ekziston dhe se deputetët e Kuvendit të Shqipërisë llojnë zëshëm për Kosovën. Ky bashkëpunim, tha se do të vazhdojë edhe më tutje dhe se ambasadori do të jetë ndërmjetësues i këtij bashkëpunimi.

**Xhavit Haliti**, i uroi mirëseardhje ambasadorit dhe njoftoi se është rritur dhe edukuar më atë se çfarë ka prodhuar Shqipëria. Kinematografia shqiptare e patriotizmit, e lëvizjeve, tha se ka pasur qëllim edukimin e brezave e veçanërisht në Kosovë e në emigracion ka qenë edukim dhe mobilizim, ndoshta edhe shpirtëror për të vepruar. Katër shtyllat e çlirimit të Kosovës, tha se janë diaspora, UÇK-ja, NATO dhe Shqipëria, këto nuk e ndajnë vetëm suksesin, por edhe përgjegjësinë e tyre të bashkëpunimit për të shkuar aty ku po orientohet të shkojë Kosova. Në bashkëpunimin në mes të institucioneve të Kosovës dhe Shqipërisë, tha ka pasur batica e zbatim, por është i bindur se çdo njeri e ka të njëjtin mendim, dhe se mënyrat se si interpretohet koha e veprimit dhe çfarë veprohet ndikohet nga situata që krijohet ose imponohet nga të tjerët.

Haliti shprehu mendimin se ambasadat në Tiranë dhe Prishtinë duhet të kenë mision të veçantë dhe se ambasadorët duhet të kenë status të veçantë, por se ka të meta edhe në këtë aspekt, duke shtuar se Kryeministri i Shqipërisë nuk e ka takuar asnjëherë ambasadorin e Kosovës. Raportet në mes të dy qeverive dhe parlamenteve duhet të kalojnë përmes dy ambasadave, për aq sa është e mundur. Kërkoj nga ambasadori meqë vjen nga fusha e kulturës, që të angazhohet në ngritjen e raporteve kulturore në mes të Kosovës dhe Shqipërisë dhe i shprehu ngushëllime për vdekjen e Mirush Kabashit, që ka qenë një aktor dhe artist i madh i kombit.

**Petrit Malaj**, sa i përket fushës së kulturës bëri të ditur se e ka në misionin e tij rritjen e marrëdhënieve në këtë fushë. Njoftoi se e ka takuar ministrin e kulturës, ku ka parë një vullnet tek ai për rritjen e këtyre marrëdhënieve. Nëse nuk ka komunikim të duhur kulturor në mes Kosovës dhe Shqipërisë, nuk mund

të shpresohet që të ketë me të tjerët. Lidhur me mungesën e komunikimit të Kryeministrit shqiptar me ambasadorin e Kosovës, tha se do ta përcjellë këtë çështje.

**Time Kadrijaj**, i uroj mirëseardhje ambasadorit duke shtuar se ky takim është më shumë i karakterit njoftues dhe për t'i uruar punë të mbarë ambasadorit në detyrën e tij të re. Komisioni ka pasur takime me deputetë dhe komisione parlamentare të Kuvendit të Shqipërisë, dhe se gjatë këtyre takimeve iu është thënë se pika e përbashkët që e bënë bashkë pozitën dhe opozitën në Shqipëri është vetëm Kosova. Kosova është në një situatë jo të mirë, ku siguria është e brishtë dhe ku po pengohet anëtarësimi i saj në organizata ndërkombëtare. Kosova po ashtu, është duke u ballafaquar me një dialog, i cili nuk është i drejtë. Lidhur me këtë shtoi se Evropa dhe BE-ja duke dashur që Serbinë ta orientojnë drejtë BE-së, po përdorin standarde të dyfishta. Kosova, tha se duhet të llojë që me procedura të përsheptuara, siç ka ndodh me Finlandën dhe Suedinë, të anëtarësohet në NATO dhe në mekanizmat tjerë ndërkombëtarë. Bëri të ditur se politikat e BE-së nuk janë të drejtpërdrejta, nuk janë të rrepta, po përdoren standarde të njëjta, si për Kosovën ashtu edhe për Serbinë. Kjo më së mirë shihet me rastin terrorist që ndodhi në shtator në Kosovë. Serbia ende nuk është sanksionuar për sulmin terrorist, i cili për fat të mirë është lokalizuar dhe se po shihet se ka tendenca të sulmeve të tjera të vazhdueshme nga Serbia dhe tha se i vjen mirë që në kuadër të KFOR-it Shqipëria do t'i shtojë trupat e saj në Kosovë, të cilët janë të mirëpritura.

**Petrit Malaj**, duke iu referuar diskutimit të deputetes Kadrijaj, tha se Shqipëria e ka detyrim mbështetjen ndaj Kosovës dhe se këtë do ta bëjë edhe në vazhdimësi. Lidhur me regjimentin e ushtrisë së Shqipërisë në kuadër të KFOR-it, bëri të ditur se me rastin e 111 vjetorit të ushtrisë shqiptare ishte në Pejë, ku u takua me ushtarët. Sa i takon dialogut me Serbinë, tha se ka pasur një presion nga BE-ja, i cili është për tu admiruar. Ministrja gjermane ka pasur një përkushtim të saktë, kur i thotë Serbisë se më nuk mund të qëndroj në dy karrige dhe se ka ardhur momenti që duhet të zgjedh karrigen. Parlamenti i Shqipërisë dhe ai i Kosovës kanë një partneritet strategjik dhe ky partneritet strategjik mund të shihet tek takimet që janë mbajtur në Tiranë dhe në Prishtinë.

**Gazmend Gjyshinca**, tha se të gjithë deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë mirënjohje për angazhimin e institucioneve të Republikës së Shqipërisë për Kosovën, duke filluar nga Presidenti Begaj, Kryeministri Rama, znj. Nikolla, ministri për Punë të Jashtme z. Hasani etj. Në Tiranë, tha se janë mbajtur dy samite të mëdha, ai i BE-së me gjithë kryeministrat e vendeve të BE-së, si dhe ai i Procesit të Berlinit. Lidhur me këtë shtoi se Shqipëria është duke e shënuar klimaksin e saj diplomatik në vitet e fundit dhe kjo pa dyshim që Kosovën e gëzon dhe do të dëshironte ta shihte të tillë edhe në vitet në vijim. Njoftoi se i ka disa pika të veçanta për të cilat do të dëshironte që ambasadori shqiptar të angazhohej. E para, tha se ka të bëjë me marrëveshjet e arritura. Kërkoj që ambasadori të angazhohet të mbikëqyrja e zbatimit të këtyre marrëveshjeve për arsye se ka shumë pika që dalin nga këto marrëveshje nuk janë zbatuar asnjëherë. Çështja e dytë, tha është anëtarësimi në NATO. Lidhur me këtë kërkoj që Shqipëria të ketë një rol prijatar lidhur me marrëveshjen të Partneritetit për Paqe dhe të shtoi dinamikën e punës. Shqipëria po ashtu, do të mund të angazhohej që në Kartën e Adriatikut, ku Kosova e ka rolin e vëzhguesit, të ngrit rolin e Kosovës brenda këtij mekanizmi.

Çështje tjetër që e prek punën e komisionit, tha se është çështja e ambasadave të përbashkëta. Njoftoi se janë disa raste në mes të Kosovës dhe Shqipërisë, që ka ambasada të përbashkëta dhe do të dëshironte të shihte një angazhim të theksuar për të rritur numrin e këtyre ambasadave. Lobimi i Shqipërisë tek kontinentet sikur është Amerika e Jugut, Afrika dhe Azia është një çështje tjetër të cilën e ngriti. Shqipëria ka një sistem të etabluar të shërbimit diplomatik dhe në veçanti në Azi do të dëshironte që Kosova të ketë një krah më të fortë nga Shqipëria. Si mision të veçantë i të gjithëve e cilësoi mirëmbajtjen e narrativit kombëtar si në Kosovë ashtu edhe në Shqipëri. Lidhur me këtë shprehu mendimin se gjatë viteve të fundit ka pasuar momente të cilat kanë treguar se populli, artistët, shoqëria,

organizatat e shoqërisë civile, janë shumë më përpara sesa politika në këtë aspekt. Mirëmbajtja e këtij narrativi kombëtar është detyrë mbi të gjithë dhe më i rëndësishëm se çdo gjë tjetër teknike, shtoi deputeti Gjyshinca.

**Petrit Malaj**, lidhur me mirëmbajtjen e narrativit kombëtar tha se nuk ka asgjë të shtoj rreth asaj se çfarë tha deputeti Gjyshinca. Lidhur me zbatimin e marrëveshjeve njoftoi se është në misionin e tij që ato të mos ngelen në letër, por të shohin zbatim. Janë rreth 184 marrëveshje bashkëpunimi në mes të dy shteteve, ku dritën e ekzekutimit të tyre e kanë e kanë parë rreth 54. Sa i përket problemit të NATO-s, tha se edhe ai e ka dëshirën për ta biseduar këtë çështje në strukturat përkatëse dhe se duhet kaluar aspekti i Partneritetit për Paqe, para se të flitet për anëtarësim në NATO. Kjo çështje, tha se është në vëmendjen e Republikës së Shqipërisë. Kartën e Adriatikut, tha se vitin tjetër i takon Shqipërisë drejtimi i saj, dhe njoftoi se ka një pikësynim të qartë për Kosovën aty, që të mos jetë në rolin e vëzhguesit, por të jetë aty ku duhet dhe të ketë karrigen e vet për të komunikuar si çdo vend tjetër. Ambasadat e përbashkëta, tha se tashmë janë realitet dhe bëri të ditur se ka disa shkëndija pozitive për disa momente interesante të bashkëpunimit në mes të dy ministrive të jashtme në këtë fushë.

**Ariana Musliu-Shoshi**, i uroi punë të mbarë dhe suksese ambasadorit në punën e tij. Bëri të ditur se delegacioni i Shqipërisë në Asamblenë Parlamentare të KE-së ka bërë shumë për Kosovën duke i tejkaluar shpeshherë edhe interesat e saj në mënyrë që të jetë zëri i Kosovës. Për këtë mbështetje, tha se është shumë falënderuese. Duke u ndërlidhur me diskutimin e deputetit Haliti, sa i përket përfaqësimit të ambasadorit të Kosovës në Republikën e Shqipërisë, njoftoi se ambasadori Durmishi është një ambasador karriere, i cili në bazë të ligjit kur i mbush 65 vite duhet ta lirojë detyrën. Nëse ministria dëshiron ta mbajë në detyrë, ai duhet të kthehet në ambasador politik, por nuk është e dinjitetshme që ai të qëndroj si ambasador karriere. Lidhur me ambasadat e përbashkëta, tha se ka pasur neglizhim dhe se nuk është shfrytëzuar kjo mundësi nga Ministria për Punë të Jashtme dhe pyeti ambasadorin, nëse ai mund të ndajë me komisionin, se në cilat vende është paraparë të ketë bashkëpunim me ambasada të përbashkëta.

**Petrit Malaj**, tha se Kryeministri Rama, kudo ku ka mundësi dhe kudo që diskutohen problematikat e rajonit, gjithmonë e ngre zërin për Kosovën. Sa i takon ambasadave të përbashkëta, bëri të ditur se hapat e parë tashmë janë hedhur dhe se ministri i jashtëm do të bëjë një vizitë në Kosovë në fillim të vitit 2024, ku do të diskutohen më tej këto çështje.

Mbledhja përfundoi në orën 10:50.

E përgatiti:  
Stafi mbështetës i Komisionit.

Arbëreshë Kryeziu Hyseni

---

Kryetare e Komisionit